



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

DOKUMENT INFORMUES
MBI
DISPOZITAT E KODIT ZGJEDHOR
PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE SHTETËRORE NË ZGJEDHJE

Prej datës 25 dhjetor 2020 kanë nisur efektin e tyre dispozitat e reja të Kodit Zgjedhor, të cilat parashikojnë ndalimin e veprimtarive publike dhe përdorimit të burimeve shtetërore në një periudhë 4 mujore deri në zgjedhjet për Kuvend të dates 25 Prill 2021. Këto kufizime synojnë krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike, që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime të subjekteve zgjedhore.

Dispozitat e reja të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktojnë si më poshtë vijon:

Neni	Pika	Dispozitat e Kodit Zgjedhor
Neni 91	Pika 1	Nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.
	Pika 3	Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura.

	Pika 4	Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore
Neni 92	Pika 1	Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.
	Pika 3	Raportimi sipas pikës 1 të këtij neni kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. (Detajuar në nenin 92/5)

Bazuar mbi këto dispozita është miratuar **Vendimi nr.9, dt 24.12.2020** i Komisionit Rregullator mbi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Disa prej detyrimeve dhe kufizimeve kryesore renditen më poshtë:

NDALOHEN

Nga 25 dhjetor 2020 – 25 prill 2021

(Katër muaj para datës së zgjedhjeve)

Veprimtaritë publike të zyrtarëve të institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore

Kufizimet ligjore kanë në fokus aktivitetet publike të:

- Kryeministrit dhe administrata e tij, zëvendëskryeministrit,
- Ministrit dhe zëvendësministrit dhe administrata e tyre,
- Prefekti dhe administrata e tij,
- Kryetarit të bashkisë dhe zëvendësit;
- Drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësit të agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit ose ministrit;
- Drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësit e tij për shoqëritë tregtare në të cilat shteti ka më shumë e 50% të aksioneve;
- Titullarit dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore;

VINI RE !

Deputetët aktualë nuk janë pjesë e kufizimeve të zyrtarëve të lartë në Kodin Zgjedhor. Në momentin që ata do të regjistrohen zyrtarisht si kandidatë pranë KQZ, do të nisin funksionin e tyre dispozitat përkatëse për veprimtarinë e kandidatëve në zgjedhje.

Disa nga “**veprimtaritë e ndaluara publike**”, të përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe rregulloren e miratuar në vendimin e Komisioni Rregullator, janë si më poshtë vijon:

- a) mbështetja dhe promovimi i projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet në shërbim dhe interes të publikut;

- b) mbështetja dhe promovimi i objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyror;
- c) shpërndarja në veprimtari publike e lejeve të legalizimeve, akteve për regjistrimin e tokës bujqësore apo çdo lloj titulli pronësie tjetër;

VINI RE !

Sipas vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator pranë KQZ, nuk cilësohen të ndaluara veprimtaritë, të cilat janë financuar para 25 dhjetor 2020.

Neni 3, pika 1.1

“veprimtari të ndaluara” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit në pikat e mësipërme a,b,c, për të cilat janë vënë rishtazi në dispozicion apo transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve”

Raportimi dhe sanksionet administrative

Të gjithë subjektet e specifikuar më sipër ngarkohen me detyrimin për të raportuar aktivitetin e tyre publik, minimalisht 5 (pesë) ditë përpara zhvillimit, nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike (<https://aktivitete.kqz.gov.al>), e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja.

Raportimi në ndërfaqe, në emër dhe për llogari të subjekteve të përcaktuara, bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore (monokratike ose kolegjiale), drejtorët e përgjithshëm apo drejtuesit më të lartë administrativë për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e Kryeministrit, drejtuesit ekzekutivë të shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në kapitale, kuota e aksione më shumë se 50 për qind të aksioneve, drejtuesit ekzekutivë të ndërmarrjeve shtetërore, enteve publike, si dhe Administratorët e Njësive Administrative (Neni 4, pika 4).

Në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar sipas Kodit Zgjedhor si dhe/ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse.

Nëse subjektet nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisionieri Shtetëtor i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë,

Në rast se Komisioneri konstaton se Titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi apo veprimtaria është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga KQZ me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

➤ **Aktet ligjore që sjellin përfitime**

Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

NDALOHEN GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Nga 25 Mars 2020 – 25 Prill 2021

➤ **Emërimet, largimet nga puna**

Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

➤ Përdorimi i asetëve publike

Nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve të partive politike, ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. *“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.*

➤ Pjesëmarrja në fushatë e administratës shtetërore

Punonjësit të administratës shtetërore, **gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore**, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.

Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

Punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë:

- nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;
- punonjës policie,
- punonjës të forcave të armatosura,
- punonjës të shërbimit informativ, për sa kohë kryejnë veprimtari publike,

- punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,
- si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjera rregullohen me ligje të posaçme, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

➤ **Përgjegjësia institucionale**

Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë organizojnë menjëherë punën dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore sipas Kodit Zgjedhor si dhe kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve dhe punonjësve nën varësinë e tyre

Për informacione të mëtejshme mund të konsultoni:

- Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “**Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë**”, i ndryshuar;
- **Vendimi nr.9, dt 24.12.2020 i Komisionit Rregullator** mbi “*Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”.

Ky material informues u mundësua falë projektit “**Forcimi i Transparencës së Zgjedhjeve në Shqipëri (SETA)**” i zbatuar nga Akademia e Studimeve Politike me mbështetjen e ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në Tiranë dhe programit të përbashkët të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Aksioni kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri”.